

VENDIM
Nr.76, datë 1.8.2008

PËR SHPALLJEN E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME
PËR KRYETAR KOMUNE, KOMUNA KASHAR, TË DATËS 27.7.2008

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij, të datës 1.9.2008, me pjesëmarrjen e:

Çlirim Gjata	Kryetar
Flamur Çano	Anëtar
Dëshira Subashi	Anëtare
Dodë Prenga	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Shkëlqim Hysi	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me

OBJEKTI: Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune, komuna Kashar, të datës 27.7.2008

Baza ligjore: Neni 2, pika 34 germa “a”, neni 29, pika 1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve:

VËREN:

Në datë 27.7.2008, në Komunën Kashar, u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e komunës. Në përfundim të procesit të votimit dhe numërimit të votave nga grupet e numërimit, KZQV-komuna Kashar miratoi tabelën përmbledhëse të rezultateve dhe me vendim shpalli fitues z.Besnik Islam Fuçia. Kundër vendimit të KZQV-së Kashar brenda afatit ligjor nuk pati në KQZ asnjë ankim zgjedhor nga asnjë subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet e pjesshme për kryetar komune, komuna Kashar, të datës 27.7.2008.

Në referim të përcaktimeve të nenit 29 dhe nenit 2, pika 34, germa “a” në Kodin Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall me vendim rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në këtë njësi zgjedhore.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 2 pika 34 germa “a”, nenin 29, pika 1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

Të shpallë rezultatin e zgjedhjeve për kryetar komune, komuna Kashar të datës 27.7.2008, duke shpallur fitues z.Besnik Islam Fuçia, kandidat i mbështetur nga Partia Demokratike.